



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, 64 paragrafi 2.10, nenin 74 paragrafi 11, nenin 96 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, neni 12 paragrafi 8 të Rregullores Zgjedhore Nr.17/2024, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 07.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Listës së Zyrtarëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) për Angazhim në Përfaqësitë Diplomatike

- I. Miratohet lista me të dhënat e zyrtarëve të MPJD, për angazhim në ditën e zgjedhjeve në përfaqësitë diplomatike, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025.
- II. Lista me të dhënat si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.02.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 07.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Planit Operacional për Ditën e Zgjedhjeve

- I. Miratohet Plani Operacional për ditën e zgjedhjeve, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës 2025.
- II. Plani si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.02.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 64 paragrafi 2.1, nenin 99 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 7 paragrafi 2 të Rregullores Zgjedhore Nr.09/2024 Regjistrimi dhe Votimi i Personave me Nevoja të Veçanta, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datën 07.02.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Numrit të Komisioneve të Votimit të Ekipeve Lëvizëse (KVEL)

- I. Miratohet numri i KVEL-ve për komunat përkatëse, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Lista me numrin e KVEL-ve për komunat përkatëse si në pikën I, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 07.02.2025

Kreshnik RADONIQI

Kryesues i KQZ